

Intersig VIG është një nga kompanitë lider në fushën e Sigurimeve, e themeluar në vitin 2001 nga aksionerë vendas, e licencuar për ofrimin e shërbimeve të sigurimeve jo-jetë në Republikën e Shqipërisë. Duke filluar nga viti 2011, Intersig është anëtar i grupit të njohur Austriak - Vienna Insurance Group (VIG). VIG është një grup kompanish, pionier i inovacionit në industrinë e sigurimeve, që operon në 25 vende të Evropës Qendrore dhe Lindore.

Intersig VIG, ju ofron një karriere shpërblyese dhe krijon mundësinë ti jepni formë rrugës së zhvillimit tuaj profesional duke u bërë pjesë e një stafi të dedikuar prej më shumë se 300 punonjësish.

Pozicion Vakant Pune – Specialist i Produktit të Garancisë dhe Përgjegjesisë

Afati: 18 Qershor 2018

Roli dhe Përgjegjesite

1. Njohja e Produktit të Garancisë dhe Përgjegjesisë si dhe të gjithë produkteve dhe prezantimi i tyre saktë dhe dinjitoz tek klientët;
2. Zhvillimi i takimeve me klientët për dhënien e informacionit të detajuar në lidhje me çdo produkt të INTERSIG VIG duke u siguruar që prezantimi i informacionit tek klienti të jetë i plotë, i detajuar dhe i qartë;
3. Zgjerimi i Rrjetit të Shitjeve, përmes zgjerimit të portofolit të klientëve;
4. Regjistrimi i policave të shitura në sistemin e shitjes online të Intersig VIG dhe ndjekja e arkëtimit për çdo policë të shitur;
6. Zbatimi i procedurës për lëshimin e policave nga momenti i kontaktimit të klientit deri në nënshkrimin e kontratës së sigurimit;
7. Asistencë ndaj të siguruarve të INTERSIG VIG në rast dëmi;
8. Krijimi e përditësimi i databazës së klientëve, si dhe dergimi i njoftimeve përkatëse për rinovimet e policave, apo informimi mbi risi të Intersig VIG në lidhje me produktet, paketat, etj.;
9. Angazhimi që klienti t'i lexojë, t'i kuptojë dhe të dakordësohet me të gjitha kushtet e sigurimit dheparashikimet e tjera të kontratës së sigurimit, përpara nënshkrimit të kontratës së sigurimit;

Kandidati i suksesshëm duhet të plotësojë kriteret e më poshtme:

- Diplomë universitare, e parapëlqyer në Menaxhim, Marketing, Financë dhe Juridik;
- Eksperiencë 1 vit në shitje, preferohet në Distribucion, Sektorin e Shit-Blerjes së Pasurive të Paluajtshme (Real Estate), Shërbimet e Leasing-ut, etj;
- Aftësi shumë të mira komunikuese dhe bindëse;
- Aftësi shumë të mira negociuese për të mbyllur procesin e shitjes;
- I/E e vendosur dhe orientuar drejt objektivave të shitjes;
- Njohuri e mirë e gjuhës angleze është e detyrueshme. Zotërimi i gjuhëve të tjera të huaja përbën avantazh;
- Gatishmëri dhe disponibilitet për të udhëtuar brenda dhe jashtë vendit për qëllime pune.

Nëse mendoni se jeni gati për t'ju bashkuar një grupi ndërkombëtar në Tregun e Sigurimeve dhe të bëheni pjesë e një stafi dinamik, i cili rritet dhe zhvillohet çdo ditë atëherë ju mirëpresim në Intersig VIG.

Lutemi të dërgoni aplikimin tuaj brenda datës **18 Qershor 2018** ne adresen e emailit
HumanResources@intersig.al

Vetëm kandidatët e përzgjedhur nga faza e shqyrtimit të CV-ve do të njoftohen për ndjekjen e fazave të tjera të këtij procesi rekrutimit.